



VENDIM

Nr.115 Datë. 01.12..2014

PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË
“POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 5 pika 1 gërma “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **01.12.2014**, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë ”POWER ELEKTRIK SLLABINJE” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është i plotësuar pjesërisht.(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave)

- Dokumentacioni teknik Neni 9, pika 4.9 gërma a,b dhe c janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
- Per dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr.115 Datë. 01.12.2014

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË
“POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundra
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____